

# RADIODIFUZERËT NUK E KANË SHKELUR HESHTJEN

**Shkup, 01.10.2018** – Pas kontrollit të mënyrës së informimit të radiove dhe televizioneve gjatë heshtjes së referendimit, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ju informon se asnjë radiodifuzer që ishte pjesë e monitorimit, nuk e ka shkelur heshtjen .

Radiodifuzerët e kanë plotësuar obligimin e tyre profesional për informim të qytetarëve në kontekst specifik, që është karakteristik për heshtjen e referendimit, duke mos i shkelur rregullat në fuqi.

Gjatë ditëve në vijim Agjencia do të publikojë raportet për shkeljet e konstatuara në aspekte tjera ligjore, si dhe raportin për mënyrën e mbulimit të referendimit gjatë 9 ditëve të fundit të fushatës.